



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBER
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 119 Datë 15.09.2020

Për miratimin e subvencionimit të Ujësjellës Kanalizime Dibër mbi Kontratën e Shërbimit “Shërbimin e hartimit të raportit mbi gjendjen faktike të evidencave financiare dhe jo financiare për vitin 31.12.2019”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, po dërgojmë për miratim akordimin e fondit për miratimin e subvencionimit të Ujësjellës Kanalizime Dibër mbi Kontratën e Shërbimit “Shërbimin e hartimit të raportit mbi gjendjen faktike të evidencave financiare dhe jo financiare për vitin 31.12.2019”: Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e datës 30.07.2020 miratoi me 18 vota pro 3 kunder 0 apstenim.

VENDOSI :

1. Miratimin e akordimit e fondit për miratimin e subvencionimit të Ujësjellës Kanalizime Dibër mbi kontratën e Shërbimit “Shërbimin e hartimit të raportit mbi gjendjen faktike të evidencave financiare dhe jo financiare për vitin 31.12.2019”: me vendimin nr.01 datë 06.03.2020 “Mbi miratimin e ekspertit kontabël të autorizuar për hartimin e raportit mbi gjendjen faktike të evidencave financiare dhe jo-financiare deri më 31.12.2019”.

Të pakësohet :

Gr.0,0 Tit. 1810 Kap. 1 Art.604 1.440.000 lekë

Të shtohet:

Gr.0,0 Tit. 1110 Kap. 1 Art.604 1.440.000 lekë

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli
Sokol Sava